

EDISON XHAKONI
PORTRET I TURBULLT
POEZI

BOTIMET TOENA

EDISON XHAKONI

PORTRET I TURBULLT

Libri I

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

Në kopertinë: “Të dua”, pikturë nga Lon.

ISBN 978-9928-277-94-7

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Rënia

U bënë disa poezi
Që i shkruaj pa përkushtim;
Pa iu dhënë i gjithi frymës,
Pa i mbyllur sytë,
Pa thënë krejt të vërtetën,
Pa u çliruar!
Jam bërë si punëtor minierash,
Që gërmon kuturu, me shpresën të gjejë ar,
Pa ndier asgjë, veç lakmisë,
Pa e ditur, ky ar, si është.
Jam në rënie, në rrokullisje
Poezia më ka braktisur
Është arratisur prej meje, s'më do më
S'jam më i preferuari i saj.
Ndoshta mund të jetë mërzhitur,
Sepse e kam tradhtuar vazhdimisht,
Duke e quajtur pronë timen
Duke harruar, që në fakt,
Unë jam një skllav i përlur i saj
Skllav që kam të drejtë të zgjedh,
Por ka ndëshkim dhe shpërblim,
Ka një pasojë për çdo veprim.

*

Pra, kështu u krijokan perënditë,
Prej poetësh, dashnorë të diçkaje,
Skllëvër të dëshirave të mendjes,
Të fantazive të zemrës,
Ëndërrimtarë, që krijojnë në vete
Ferrin dhe parajsën vetjake,
Të ushqyera prej të njëjtit zjarr:
Zjarrit të dëshirës për të dashuruar.

*

E kam tradhtuar poezinë vazhdimisht,
Kur kam refuzuar t'i them të vërtetat,
Kur s'e kam shkruar,
Për të mos lënduar dikë.
E për të mos përjetësuar
Ndjenjat e mia më të këqija,
Urrejtjen e zemërimin,
Prej bindjes së gabuar,
Që vetëm gjërat e bukura meritojnë të shkruhen
Duke harruar,
Që të këqijat, janë si bimët helmuese,
Lëshojnë rrënjë
Shkaktojnë dëme, nëse nuk shkulen,
E nëse për to nuk tregohet.

Ndaj, poezia më ka mënjanuar,
Nuk më quan më të denjë t'i shërbej.
Si një ushtar i çnderuar në fushëbetejë,
Mund të fitohet lavdia dhe turpi;
Unë fitova turpin, duke kërkuar lavdinë.
Dhe poezia ime, perëndesha ime vetjake,
Dhurata ime, kuptimi im
Më ka lënë të endem i etur
Për zjarrin e saj, për frymën e saj...

*

Trupi im ndien akoma praninë
Është një frymë,
Është një shpirt.
Më ngushëllon e më merr në krahë
Më veçon e më përkund,
Më thotë: "S'kam ikur askund!
Por je një ushtar i lodhur,
Ke rënë, ndaj përkushtohu!".
Të lutem! Afrohu...

Ndryshe

Të lindësh... I ndryshëm.
Ndoshta i vetmi fëmijë në planet
I paaftë të shqiptosh germën “L”!
Fëmijë i çuditshëm,
Fëmijë i pafëmijë,
I burgosur në kafkën e ngushtë
Plot pyetje e dyshime
I paaftë për të kuptuar
Pse s’i kupton dot lojërat e fëmijëve të tjerë
I paaftë, përballë çdokujt
Për të bërë ato çka bëjnë fëmijët.

Dhe rritesh,
Dhe sheh,
Që asnjë i rritur nuk i kupton lojërat e të rriturve të
tjerë
E vetë je fëmijë, në trup burri,
E sillesh si burrë, me lehtësinë e një fëmije,
Gënjën me pafajësinë e një fëmije
Dhe të mundon e njëjta pyetje
Jam i çmendur, apo i bekuar?

Dhe vazhdon të rritesh
Pa guxuar ta bësh atë pyetje me zë të lartë
Nga frika mos e dëgjon kush, sa turp!
Apo nga frika, se mos dikush, më në fund, i përgjigjet...

Jam i çmendur! Mirë, po tani?
Funksionoj si një njeri normal,
Mjaft të mësoj përmendësh ca gjëra.
Por, e keqja do të ishte nëse s'do të isha i çmendur...
Jam i veçantë, i bekuar,
Jam i bekuar me një dhuratë...
Por a jam i denjë?
Vetëm telashe vijnë prej përgjigjesh,
Më shumë pyetje e asnjë përfitim
Se, mirë, qenkam i ndryshëm,
Ose, si të thuash... I talentuar
Ç'duhet bërë?
Se gjërat që shoh, i shoh vetëm unë,
Askujt tjetër s'do t'i hynin në punë!

Pra, i ndryshëm...
Dhe dyshimet të brejnë kafkën,
Të brejnë edhe gjoksin, ta zgavrojnë
E sytë të tradhtojnë,
E gjërat ndërlikohen
Dhe më e keqja, vazhdon e rritesh
Veten s'mund ta pranosh, përpiqesh të ndryshosh,
Por është si të kthesh qelqin në rërë,
Pasi ka qenë rërë e është bërë qelq
Në rastin më të mirë, do të gjakosesh keq
E në rastin më të keq, do të gjakosësh
E do të lëndosh këdo që të afrohet,
E do të jesh një i rritur i çuditshëm
I vetmuar,
I dyshimtë, i rrezikshëm.

Psherëtin, asnjë zgjidhje
Vetëm zgjedhje të vështira
Pyetja: Ta pranosh veten, apo të ndryshosh?
Pyet një kafshë grabitqare,
Do të pranosh që je përbindësh,
Apo do të hash gjethe?
Do të vdiste nga uria, por s'është përbindësh,
Është ashtu siç është, për të është e natyrshme.
Sa e thjeshtë qenka përgjigjja
Po njerëzit, shoqëria...
Do të ishe një kafshë në kafaz,
Në mëshirën e kureshtarëve të gjërave të rralla.